

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" Margherita Investment" Shpk



Në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Ligjit no. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", si edhe me Aktin e Themelimit të shoqërisë "**Margherita Investment**" **Shpk**, aktiviteti tregtar do të organizohet dhe drejtohet sipas kushteve të këtij Statuti.

Neni 1

Ligji i Aplikueshëm

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin dhe legjislacionin shqiptare.

Neni 2

Ortakët e Shoqërisë

Emarilda Vata, shtetase Shqiptare, e bija e Istref, lindur në dt. 21.08.1993, në Kamez, me vendbanim në Tirane, Shqiperi, titullare e Kartës së Identitetit Nr.J35821054L

Neni 3

Forma Juridike

Shoqëria është me Përgjegjësi të Kufizuar, por mund të transformohet në një formë tjetër kuridike sipas normativave në fuqi të legjislacionit tregtar në Shqipëri.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar për një periudhë **të pacaktuar kohore**. Kjo kohëzgjatje fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit.

Neni 5

Selia Ligjore

- 5.1 Shoqëria do të ketë selië në: Rr,Shyqyri Berxolli, Residence "Inter-Cosat", Njesia Nr.10, Shkalla B, Tiranë.
- 5.2 Shoqëria mund të hapë filiale dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe jashtë dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera Shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose që mund të krijohen në të ardhmen.



Neni 6
Logo

Të gjitha dokumentat e shoqërisë duhet të mbajnë Logon e saj dhe emrin e shoqërisë.

Neni 7
Objekti i shoqërisë

7.1 Objekti i shoqërisë do të jetë si më poshtë:

1. Përgatitjen dhe shitjen e pijeve, si në ambiente fikse, ashtu edhe për itinerare / ambulante të ushqimeve dhe pijeve të nxehta dhe të ftohta, shitjen dhe tregtimin e tyre
2. Shërbim për publikun si në ambiente, fikse gjithashtu në itinerarin ambulant të ushqimeve dhe pijeve, restaurimin, administrimin e mensave, familjare e ushqimit dhe gjithçka që lidhet me restorantet;.
3. Ndermjetësim në shitje dhe dhënie me qera pronash të Paluajtshme. Krijim, zhvillim zyra ndermjetësimi, plane, mjete marketingu, për pasurive të paluajtshme deri në nëshkrimin e kontratës; përfaqësim pronarësh, përfaqësim investitorësh në lidhje me sektorin e Pasurive të Paluajtshme.
4. Administrim dhe Menaxhim Projektësh. Promovimi, krijim dhe pjesëmarrje në nisma promovuese të rëndësishme lokale, kombëtare ose të huaja (përfshirë edhe hapjen e zyrave apo agjencive të reja).
5. Veprimtari të konsulencës në fushën e marketingut, reklames, marrëdhënieve me publikun, kërkimeve të tregut, sponsorizime dhe konsulencë në përgjithësi, aktivitete menaxhimi, marketingu, publiciteti dhe në fushën e medias; Aktivitetet e shërbimit në përgjithësi midis të cilave organizimi i eventeve, kongreseve, manifesting, panairë dhe ekspozita, kurse të formimit profesional.

7.2 Aktiviteti i shoqërisë mund të transformohet dhe/ose shtrihet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



Neni 8 **Kapitali Themeltar**

- 8.1. Kapitali Themeltar i shoqërisë caktohet në **100 000 (njëqind mijë Leke)**.
- 8.2. Kapitali Themeltar përbëhet nga një kuotë e vetme.

- *Ortaku **Emarilda Vata**, zotëron **100 %** të kapitalit, një kuotë, me vlerë nominale prej **100 000 ALL (Leke)**.*

Neni 9 **Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar**

- 9.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndër ortakët. Kuotat janë lirisht të transferueshme me trashëgimi, dhe/ose në rast ndarje të pronësisë mes bashkëshortësh.
- 9.2 Kuotat janë lirisht të transferueshme tek të tretët, si persona me kombësi shqiptare ashtu edhe të huaj, si persona fizikë ashtu edhe juridikë.

Neni 10 **Rritja/Ulja e kapitalit/Financim i ortakëve**

- 10.1 Rritja dhe ulja e kapitalit të shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit mjafton që të jetë në përputhje dhe në raport ntë drejtë me kuotat e zotëruara mund të marrin masa për nevojat financiare të shoqërisë me anë të derdhjes në llogari kapitali ose financimesh (si me interes ashtu edhe pa interes), në respektim të normativës për transparencën bankare në këtë fushë dhe me dispozitat me karakter fiskal në fuqi. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve për ortakët mund të bëhen me vendim të ortakëve, si edhe me të njëjtat mënyra mund të destinohen për të mbuluar humbjet e mundshme të ushtrimit.

Neni 11 **Asambleja e Ortakëve**

- 11.1 Asambleja e ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Asambleja drejtohet nga administratori i shoqërisë ose edhe me vendim të ortakëve, nga një person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Asambleja e ortakëve ushtron kompetencat e mëposhtme kryesore:
 - përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë,
 - ndryshimi i statutit të shoqërisë,
 - emërimi dhe heqja e administratorit të shoqërisë
 - emërimi dhe heqja e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël,




- Miratimi i kompensimit të administratorit, të likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël,
- Rritje dhe ulje të kapitalit themeltar,
- Miratim i llogarive vjetore (Balanci),
- Transformim në një formë tjetër juridike të shoqërisë,
- Mbyllje dhe prishje para kohe e shoqërisë dhe kompetenca të tjera sipas normativave të legjislacionit tregtar në fuqi në Shqipëri

- 11.3 Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit, dhe sa herë që duhet të vendoset për çështje në kompetencë të saj, edhe me videokonferencë.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga Administratori, ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me një njoftim që duhet t'i dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara mbledhjes. Njoftimi mund edhe të dërgohet me email, dhe sidoqoftë duhet të përmbajë ditën, orën, vendin e mbledhjes, si edhe rendin e ditës me çështjet që duhet të trajtohen.
- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në Asamble mbi bazën e një autorizimi paraprak me një prokurë të ortakut.

Neni 12

Marrja e vendimeve

- 12.1 Në rastin kur duhet të merren vendime që kërkojnë një korum të zakonshëm, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, nëse ortakët e pranishëm, përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit themeltar.
- 12.2 Në rastin kur duhet të merren vendime që kërkojnë një korum jo të zakonshëm, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, nëse ortakët e pranishëm, përfaqësojnë më shumë se 50% të kapitalit themeltar.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë vendos me 75% të kapitalit të pranishëm (i përfaqësuar nga ortakët), siç përcaktohet nga pika 12.2, për ndryshimin e statutit, rritjen dhe uljen e kapitalit themeltar, shpërndarjen e dividendëve dhe mbylljen dhe/ose prishjen para kohe të shoqërisë. Në raste të tjera asambleja e shoqërisë vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve të pranishëm në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të transkriptohen në një proces verbal që mban datën, vendin, rendin e ditës, emrin e personit që drejton mbledhjen dhe të personit që mban proces verbalin, çështjet kryesore dhe vendimet. Proces verbalin firmoset nga Kryetari dhe nga Sekretari (që mban proces verbalin).



Neni 13 **Administratori**

- 13.1 Administratori i shoqërisë emërohet për një mandat 3 (tre) vjeçar, zëvendësohet ose pushohet nga detyra me vendim të asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Shoqëria do të administrohet nga një administrator që është **Emarilda Vata** shtetase Shqiptare, e bija e Istref, lindur në Kamez më 21.08.1993, dhe me vendbanim në Tirane Shqiperi, titullare e Kartës së Identitetit Nr.J35821054L
- 13.3. Administratori, ndër kompetencat e tjera, ka të drejtë të administrojë aktivitetin e përditshëm të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë në Asamblenë e Ortakëve propozime që kanë të bëjnë me aktivitetin e shoqërisë, të hapë llogari bankare në emër të shoqërisë dhe të ushtrojë të drejta dhe kompetenca të tjera që ligji ose Asambleja e ortakëve do t'i njohin administratorit.
- 13.4. Administratori mund të emërojë përfaqësues "ad negotia" dhe përfaqësues në përgjithësi për akte ose kategori të caktuara aktesh.
- 13.5. Administratorit të shoqërisë i ndalohet shitje dhe/ose blerja e pasurive të patundshme, përpara se të ketë marrë miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 14 **Kontrolli financiar**

Asambleja e ortakëve mund të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën që të ushtrojnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

Neni 15 **Ushtrimi i shoqërisë**

- 15.1 Ushtrimi i shoqërisë koinçidon me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 janari deri në 31 dhjetor.
- 15.2 Bën përjashtim viti i parë i shoqërisë që fillon nga momenti i rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.



Neni 16

Bilanci dhe shpërndarja e fitimeve

- 16.1 Në fund të ushtrimit të shoqërisë Administratori përgatit, në bazë të ligjit, bilancin. Bilanci i paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të parashikuar nga ligji në fuqi.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton Bilancin vjetor vendos për shpërndarjen e fitimeve ortakëve ose të depozitohen në rezervat e posaçme të kapitalit si edhe vënien mënjane të parashikuar për rezervat ligjore të parashikuara nga ligji.
- 16.3. Deri në likuidimin e vlerës së investimit fillestar, ortakët bien dakord për faktin që nëse shoqëria do të realizojë një fitim vjetor (fitim), nga shpërndarja e dividendëve do të përfitojnë vetëm ortakët që zotërojnë përkatësisht 30% të kuotave. Më pas dividendët do t'i shpërndahen të gjithë ortakëve të shoqërisë, në raport me përqindjen e zotërimit të kuotave.

Neni 17

Likuidimi

Shoqëria vihet në likuidim sipas dispozitave ligjore.

Neni 18

Dispozita Përfundimtare


Ky statut hartohet në tre kopje në gjuhën italiane dhe shqiptare me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU

Znj. Emarilda Vata

Emarilda Vata

Data 10/06/2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU
ADRESA Ç. TOPULLI
TEL: 674010104

VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 5357

Tirane më 10/06/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2020052640264340545

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER PERIAN B. BODINAKU

DATE 10/06/2020
NR REP 5357



V2020052640264340545



VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, para meje Noter PERIAN B. BODINAKU, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Ç. TOPULLI, u paraqit personalisht:

DEKLARUES/IT:

Emarilda Vata, atësia Istref, amësia Natasha, shtetase Shqiptare, lindur në Kamëz, Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Njesia bashkiake nr. 2 Budi 156, lindur më 21/08/1993, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032874193 dhe nr. personal J35821054L, .

E cila në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noterit, dokumentin e llojit "STATUT" I Shoqërisë "Margherita Investment" Shpk, date 10.06.2020 bashkangjitur, është hartuar me vullnetin e tyre të lire dhe të plote.

Une noteri e vertetoj nënshkrimin e tij sipas ligjit.

Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER
PERIAN B. BODINAKU